

VENDIM
Nr.395, datë 28.6.2007

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT, NDËRTESE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE, NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit, ndërtesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, nga Ministria e Brendshme të Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, sipas formularit për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha